



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QENDRA E STUDIMEVE
ALBANOLOGJIKE

Nr. 121/6 Prot.

Tiranë, më 14/07 2017

URDHËR

Nr. 1, Datë 14/07/2017

**PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET DHE ORGANET
DREJTUESE NË QENDRËN E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE**

Mbështetur në Ligjin nr. 8485, date 12.5.1999 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, nenin 39, nenin 131, te ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Urdhrit nr. 361, datë 11.07.2017, të MAS, "Për fillimin e procesit zgjedhor dhe datën e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë", Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Fillimin e procesit zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Qendrën e Studimeve Albanologjike, **në datën 14.07.2017**;
2. Data e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Qendrën e Studimeve Albanologjike, është **data 14.08.2017**;
3. Senati Akademik, **brenda datës 17.07.2017**, zgjedh me votim të fshehtë, anëtarët e Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ), me përfaqësues nga çdo institut. Senati cakton edhe sekretarin e KIZ, i cili është anëtar pa të drejtë vote pranë KIZ. Drejtorët e instituteve, brenda afateve të përcaktuara, të organizojnë punën në zbatim të pikës 1, nenit 6, te rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", për të sensibilizuar personelin akademik;

1. Në zbatim të nenit 11 (Zgjedhësit dhe përgatitja e listës së zgjedhësve), të rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", DBNJSH pranë QSA në bashkëpunim me departamentet pranë instituteve, të hartojnë listat e zgjedhjeve për personelin akademik, të punësuar me kohë të plotë, **brenda datës 26.07.2017**.
2. Emrat kandidatë për anëtar të KIZ, që do të zgjidhen nga Senati Akademik, nuk duhet të jenë nga anëtarët e personelit akademik, që do të vetëkandidohen për autoritetet drejtuese ose në organet drejtuese në QSA;
3. Në zbatim të pikës 1, 2, të nenit 39, (Ankimi në Komisionin e Apelit), të rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Senati Akademik, **brenda datës 17.07.2017**, publikon kërkesën për aplikim për anëtar në Komisionin e Apelit;
4. DBNJSH të vendosë në dispozicion të komisioneve të zgjedhjeve dhe Komisionit të Apelit ambientet dhe bazën materiale të nevojshme për mirëfunksionimin e gjithë procesit zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në QSA.
5. I gjithë dokumentacioni zgjedhor, duke filluar nga ky urdhër dhe deri në përfundim të procesit të zgjedhjeve të ruhet në bazë të rregullave në kuadrin ligjor për administrimin, ruajtjen dhe arshivimin e dokumentacionit;
6. Ngarkohen në zbatimin e këtij urdhri, i gjithë personeli akademik, punonjësit e administratës, autoritetet drejtuese në QSA;
7. Ky urdhër, të shpallet në të katërt institutet dhe në faqen zyrtare të Qendrës së Studimeve Albanologjike.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

